

Vendim nr. 134 datë 12.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 12.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (I) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: IDAJET XHAFAJ, përfaqësuar nga av. Zenun Hajdarmataj, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-382, datë 11.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 23.08.2008 kërkuesi Idajet Xhafa është goditur nga një autoveturë, e drejtuar nga shtetasi G.H., duke pësuar dëmtime të rënda, të cilat janë kategorizuar si të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit, po të mos i ishte dhënë ndihma e duhur mjekësore.

Për këtë ngjarje ka pasur një procedim penal dhe me vendimin nr. 35, datë 29.01.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, drejtuesi i mjetit është deklaruar fajtor për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

2. Në datën 30.03.2009 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për shpërblim dëmi përpara shoqërisë së sigurimit “Sigma” sh.a. (“Sigma” sh.a.), si siguruesi përgjegjës i pronarit të mjetit me të cilin është shkaktuar aksidenti rrugor. Duke mos qenë dakord me vlerën 1,200,000 lekë në vit të ofruar nga shoqëria e sigurimit, e cila e ka konsideruar kërkuesin me paaftësi të përkohshme, ai është i drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e shoqërisë “Sigma” sh.a. të paguajë në favor të tij dëmin real pasuror dhe jopasuror, shpenzimet farmaceutike e spitalore, shpenzimet e tjera të nevojshme dhe të arsyeshme, si dhe kamatëvonesat, për shkak të dëmit të shkaktuar nga aksidenti rrugor i datës 23.08.2008.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5176, datë 10.05.2013, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar të paditurën, shoqërinë “Sigma” sh.a., që të paguajë në favor të paditësit (kërkuesit) dëmin real pasuror dhe jopasuror, shpenzimet farmaceutike e spitalore, shpenzimet e tjera të nevojshme dhe të arsyeshme në masën 15,381,373 lekë, si dhe kamatëvonesat e kësaj shume në vlerën 3,981,396 lekë (*vendimi i themelit*). Sekretaria gjyqësore e asaj gjykate, përmes shënimit përkatës, ka konfirmuar marrjen formë të prerë të këtij vendimi në datën 25.05.2013.

4. Në datën 12.12.2013, shoqëria “Sigma” sh.a. (pala e paditur në procesin gjyqësor) ka paraqitur në gjykatë kërkesë për ndreqjen e gabimit material në vendimin nr. 5176, datë 10.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të ometimit në dispozitivin e tij dhe në pjesën hyrëse në lidhje me praninë e kësaj pale në shpalljen e vendimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 67 akti, datë 15.01.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke ndrequr gabimin në dispozitivin e vendimin nr. 5176, datë 10.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si vijon: “Për palën e paditur në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.” (*vendimi i korrigjimit*).

5. Në datën 13.02.2014, pas njoftimit të vendimit të themelit nga sekretaria gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë, shoqëria “Sigma” sh.a. ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit kundër vendimit nr. 5176, datë 10.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për këtë ankim, pasi ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor, në përfundim të gjykimit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 946, datë 23.04.2015, ka vendosur mospranimin e tij. Sipas gjykatës së apelit, ankimi i të paditurit kundër vendimit të themelit është paraqitur jashtë afatit ligjor 15-ditor të përcaktuar në nenin 443 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi afati për paraqitjen e ankimit nga kjo palë ka filluar në datën 19.01.2014, ditë kur për atë ka marrë formë të prerë

vendimi i korigjimit (vendimi nr. 67 akti, datë 15.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), ndërkohë që ankimi është paraqitur në datën 13.02.2014. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs shoqëria “Sigma” sh.a., ndërkohë që kërkuesi ka paraqitur kundërrekurs, duke kërkuar mospranimin e rekursit të të paditurit.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-5382 (719), datë 11.12.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Sipas Kolegjit Civil, vendimmarrja e gjykatës së apelit është në zbatim të gabuar të ligjit procedural, konkretisht nenit 444 të KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së ankimit në rastin konkret, në lidhje me momentin e fillimit të afatit të ankimit në gjykatën e apelit për palën në mungesë në gjykimin në shkallë të parë, afat ky që fillonte nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në rastin konkret, arsyeton Kolegji Civil, vendimi i korigjimit (vendimi nr. 67 akti, datë 15.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) ka marrë formë të prerë në datën 04.02.2014, pasi ka përfunduar edhe afati i ankimit për personin e tretë (kërkuesin), ku pas kësaj, në datën 13.02.2014, sekretaria gjyqësore i ka komunikuar të paditurit, shoqërisë “Sigma” sh.a., vendimin e themelit (vendimin nr. 5176, datë 10.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) dhe po në këtë datë i padituri ka depozituar ankimin kundër vendimit të themelit, pra brenda afatit ligjor 15-ditor. Po kështu, Kolegji Civil ka arsyetuar se edhe sikur të pranohej dijenia e të paditurit për vendimin e themelit të shkallës së parë jo në ditën e njoftimit të tij nga sekretaria gjyqësore, por në ditën kur vendimi i korigjimit ka marrë formë të prerë, përsëri ankimi në rastin konkret është paraqitur brenda afatit ligjor. Për rrjedhojë, Kolegji Civil e ka gjetur të gabuar vendimin e gjykatës së apelit, duke disponuar prishjen e tij dhe dërgimin e çështjes në atë gjykatë për shqyrtimin e ankimit të të paditurit.

7. Në datën 29.03.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 11.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të:

8.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Civil, në interpretim të gabuar të ligjit, ka vendosur revokimin e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, për të

cilin palët nuk janë njoftuar, duke shkelur ligjin procedural për sa u përket rasteve të gjykimit në mungesë.

- 8.2. *Së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, sepse dhoma e këshillimit nuk ka të drejtë të gjykojë në themel çështjet.* Gjykata e Lartë ka vepruar në shkelje të ligjit procedural, pasi ajo mund ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore dhe vetëm atje mund të prishte vendimin e gjykatës së apelit. Në dhomën e këshillimit vendoset vetëm nëse rekursi duhet të pranohet nga ana formale, ndërkohë që ajo gjykatë, në një procedurë jo korrekte, ka vendosur për vlerësimin e provave, çka nuk është kompetencë e saj si gjykatë e ligjit. Kolegji Civil në dhomën e këshillimit ka marrë një vendim në tejkalim të kompetencave të parashikuara nga ligji.
- 8.3. *Së drejtës për t`u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur,* pasi seanca është zhvilluar në mungesë të kërkuarit ose përfaqësuesit të tij, edhe pse është detyrë e autoriteteve të njoftojnë palët për seancën, për respektimin e një procedure të rregullt gjyqësore dhe konform ligjit.
- 8.4. *Standardit të arsytimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar faktin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka marrë formë të prerë dhe kërkesa ka qenë me objekt ndreqje gabimi dhe plotësim vendimi, siç është shprehur ajo në vendim. Po të ishte plotësim vendimi, ai duhej të ishte gjykuar pas një muaji siç e parashikon ligji procedural, neni 314 i KPC-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së

kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, në cilësinë e palës paditëse, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: *i)* kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës; *ii)* kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion. Ai përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se në rastin konkret objekt i kërkesës në shqyrtim është kundërshtimi i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur prishjen e vendimit nr. 946, datë 23.04.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tjera me natyrë jo përfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse

plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Në këtë kuptim, Gjykata verifikon nëse natyra e pretendimit të ngritur justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues. Pra, ajo verifikon nëse shkelja është e tillë që pasojat e saj nuk mund të riparohen më gjatë rigjyimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm. Në këto raste Gjykata, nëse kërkuesi nuk ka mjete të tjera ligjore efektive në dispozicion për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, vlerëson se ai legjitimohet për kundërshtimin e këtyre lloj vendimesh (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji, bazuar në rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim, vëren se gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të të paditurit në procesin gjyqësor të themelit, si të paraqitur jashtë afatit ligjor 15-ditor, ndërkohë që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi bazën e një interpretimi të ndryshëm të ligjit procedural në raport me rrethanat faktike të rastit në shqyrtim, ka arritur në përfundimin se ankimi në gjykatën e apelit i të paditurit është paraqitur brenda afatit ligjor dhe çështja duhet të shqyrtohet në themel prej asaj gjykate.

14. Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjyimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më sipër, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, si dhe referuar përmbajtjes së vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se ajo gjykatë, jo vetëm që ka vepruar në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, duke interpretuar dispozitat procedurale të zbatueshme në rastin konkret ndaj fakteve të çështjes konkrete, por edhe se ky interpretim nuk duket të jetë arbitrar apo haptazi i paarsyeshëm në atë masë që do të vinte në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Për sa kohë që në rastin konkret nuk konstatohet një shkelje e tillë, pasojat e së cilës nuk mund të riparohen më gjatë rigjyimit të çështjes, Kolegji vlerëson se nuk jemi përpara rastit përjashtimor që lejon shqyrtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur kthimin e çështjes së kërkuesit për rigjykim. Për rrjedhojë, Kolegji arrin në përfundimin se në rastin

konkret nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike, për shkak të natyrës jopërfundimtare të vendimit të kundërshtuar.

16. Në kushtet kur kriteri paraprak për shterimin e mjeteve juridike nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

17. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.